VENDIM
Nr.332, datë 17.3.2010

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTEVE PËRBËRËSE, MËNYRËS SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 25 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forma dhe elementet përbërëse të dokumenteve që mban dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile, të jenë sipas modeleve bashkëlidhur në lidhjen nr.1, përkatësisht:

a) Mod.nr.1, aktlindjeje;
b) Mod.nr.2, aktmartese;
c) Mod.nr.3, aktvdekjeje;
ç) Mod.nr.4. procesverbal për ndryshim emri/mbiemri;
d) Mod.nr.5, procesverbal për bashkim familjeje;
dh) Mod.nr.6, procesverbal për veçim familjeje;
e) Mod.nr.7, procesverbal prë njohje atësie;
ë) Mod. nr.8, shpallje martese;
f) Mod. nr.9, vendim për pezullimin e procedurës për lidhje martese;
g) Mod.nr.10, vendim për refuzim për lidhje martese;
gj) Mod.nr.11, vendim për ndreqje gabimi material;
h) Mod.nr.12, leje varrimi;
i) Mod.nr.13, certifikatë për përdorim brenda vendit;
j) Mod.nr.14, certifikatë lindjeje, për përdorim nga autoritetet e huaja;
k) Mod.nr.15, certifkatë për lidhje martese, për përdorim nga autoritetet e huaja;
l) Mod.nr.16, certifikatë martese, për përdorim nga autoritetet e huaja.

2. Certifikata për përdorim brenda vendit do të ketë numër rendor progresiv, në të cilin tre numrat e parë tregojnë kodin e përcaktuar për çdo zyrë të gjendjes civile, sipas lidhjes nr.2, të bashkëlidhur, dhe 6 shifrat e tjera numrin e serisë së certifikatës.

3. Të gjitha dokumentet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, plotësohen on-line nga nëpunësit e nëpunësit e zyrës së gjendjes civile në bashki, njësi bashkiake e komuna nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

4.Përmasat e fletëve të dokumenteve bazë të gjendjes civile janë të formatit A-4.

5.Afati i ruajtjes së dokumenteve, sipas modeleve, është së më poshtë vijon:

a) Me ruajtje të përhershme, mod.nr.4, mod.nr.5, mod.nr.6, mod.nr.7 dhe mod.nr.11;
b) Me ruajtjes për një periudhë dyvjeçare, mod.nr.8;
c) Për një periudhë njëvjeçare, mod.nr.9 dhe mod.nr.10.

6. Specifikimet teknike të shtypshkrimeve dhe mënyra e lidhjes së akteve e të procesverbaleve përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

7. Vendimi nr.828, datë 11.12.2003, i Këshillit të Ministrave "Për formën, mënyrën e mbajtjes, elementet përbërëse dhe afatin e përdorimit të dokumenteve të gjendjes civile", i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha